ZHVILLOHET FORUMI MBI EDUKIMIN E QYTETARISË DIGJITALE: “TË MBËSHTESIM QYTETARËT E RINJ DIGJITALË”!

2022-06-06

Instituti Shqiptar për Çështjet Publike - AIPA në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës, zhvilloi, ditën e premte, datë 3 qershor 2022, Forumin mbi Edukimin e Qytetarisë Digjitale: “Të mbështesim qytetarët e rinj digjitalë”. Ky forum u organizua në kuadër të projektit "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri", i cili zbatohet nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Në këtë kuadër, aktiviteti u hap me fjalën përshëndetëse të Shefes së Zyrës së Këshillit të Evropës, znj. Jutta GÜTZKOW, si dhe u pasua nga diskutime mes profesionistësh, përfaqësues të institucioneve shtetërore, drejtues dhe nxënës të 4 shkollave të mesmë në Tiranë, përmes dy paneleve kryesore.

Respektivisht Paneli nr. 1 ishte i përbërë nga:

- Znj. Suela KUSI - Oficere e Lartë Projekti pranë Zyrës së Këshillit të Evropës;
- Znj. Anisa SUBASHI - Drejtore e Shërbimit Social, Bashkia Tiranë;
- Znj. Alma TANDILI - Kryetare e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Z. Hergis JICA - Drejtor i Zyrës së Krimit Kibernetik, Policia e Shtetit;
- Znj. Eneida FRASHËRI - Psikologe, Pedagoge pranë Universitetit Barleti.

Ndërsa Paneli nr. 2 u përbë nga:
- Znj. Nazmie KOLA - Shkolla e mesme “Aleks Buda”;
- Znj. Klotilda JAUPI - Drejtore e Shkollës së mesme “Qemal Stafa”;
- Znj. Jerina FUGA - Shkolla e mesme “Sami Frashëri”;
- Znj. Mira KOTOBELLI - Drejtore e Shkollës së mesme “Sinan Tafaj”.

Një sesion i veçantë i’u dedikua qytetarisë digjitale në këndvështrimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe në këtë kuadër nxënës të shkollës së mesme “Aleks Buda”, "Qemal Stafa", "Sami Frashèri dhe "Sinan Tafaj" prezantuan punimet e tyre lidhur me këtë temë.

Ky forum është pjese e kalendarit të aktiviteteve në kuadër të titullit Tirana Kryeqyteti Europian i Rinisë dhe në këtë kuadër Menaxheri i Programit të TEYC 2022, z. Ergys GEZKA ndau me të gjithë pjesëmarrësit një informacion të detajuar lidhur me titullin dhe programet.

Në përfundim, ky forum kishte si qëllim të informonte dhe ndërgjegjësonte fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës, mësuesit, prindërit, si dhe përfaqësuesit e institucioneve publike mbi qytetarinë digjitale, të drejtat online përgjatë qëndrimit dhe lundrimit në internet me qëllim garantimin e mirëqënies së çdo qytetari digjital në Shqipëri, me fokus të veçantë fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë!